

Përshëndetje,

duke ju kërkuar ndjesë për vonesën, lutem gjeni në vijim përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion, përgatitur nga sektori përkatës:

Aktualisht pagesa e kategorisë “sanitar” në qendrat shëndetësore të shërbimit parësor, mbështetet në Udhëzimin nr. 1, të Këshillit Administrativ të Fondit, datë 03.05.2017 “Për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për punonjësit e qendrave shëndetësore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

Sipas këtij udhëzimi elementet e pagës mujore për këtë kategori janë minimalisht:

- Paga bazë 26500 lekë
- Shtesa për vjetërsi në punë e llogaritur 1% mbi pagën bazë, për jo më shumë se 25 vjet,
- Pagesa e vështirësise e dëmshmerisë në vlerën 20% mbi pagën bazë, pra 5300 lekë.

Paga minimale mujore e llogaritur si më sipër, është minimalisht 31800 dhe maksimalisht, per elementet e mesiperm, 38425 lekë.

- Kjo pagë është konform VKM, datë 16.12.2020, e cila ka vendosur rritjen e pagës minimale ne shkalle vendi nga 26,000 në 30,000 lekë.
- Pas miratimit të VKM nr 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, e cila ka vendosur rritjen e pagës minimale nga 30,000 në 32,000 lekë, FSDKSH ka paraqitur për diskutim në mbledhjen e Këshillit Administrativ ndryshimin në Udhëzim dhe në rregullore, miratimi i së cilës pritet në mbledhjen e radhës së Këshillit Administrativ.
- Pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 158, qendrat shëndetësore paguajnë sanitarët me më pak se një vit punë, deri në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi të miratuar me VKM. Në bazë të parimit të së drejtës, prevalon akti ligjor specifik.
- Efekti financiar i këtij ndryshimi nis nga hyrja në fuqi e VKM nr. 158 datë 12.03.2022.

Ndryshimet në pagesat për kategorinë “sanitar” në qendrat shëndetësore të shërbimit parësor kanë qenë gjithmonë konform akteve ligjore në fuqi.

Me respekt,